



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRIZREN

Numri i lëndës: 2023:228929

Datë: 12.03.2024

Numri i dokumentit: 05439638

C.nr.3392/2023

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN-Departamenti i përgjithshëm, Divizioni Civil, gjyqtari Taulant Rexhëbeqaj, në çështjen juridike kontestimore të paditësit N.K. me numër personal me vendbanim në Prizren, të cilën me autorizim e përfaqësojnë avokatët B.K. dhe F.G. nga Prizreni, kundër të paditurës M.A.Sh.T. dhe Inovacionit –në Prishtinë, të cilën e përfaqëson Avokatura Shtetërore, në Prishtinë, me objekt të padisë: për kompensimin e shujtave ditore, vlera e kontestit 418.00 euro, jashtë seance, me datë **12.03.2024**, mori këtë:

A K T G J Y K I M

- I. APROVOHET PJESËRISHT** kërkesëpadia e paditësit N.K. nga Prizreni, **si e bazuar.**
- II. DETYROHET** e paditura, M.A.Sh.T. dhe Inovacionit –në Prishtinë, që paditësit N.K. në emër të kompensimit të shujtave për 186 ditë pune (nga dt.01.01.2022 deri me dt. 21.11.2022), t’ia paguaj shumën prej nga 2 euro, apo **shumën e përgjithshme prej 372.00 € (treqind e shtatëdhjetë e dy) euro**, me kamatë ligjore prej 8% në nivel vjetor, e cila fillon të rrjedhë nga data e paraqitjes së padisë 27.10.2023, e deri në pagesën definitive, të gjitha këto në afat prej 7 ditësh, pas pranimit të këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarimit të detyrueshëm.
- III.** Pjesa tjetër e kërkesëpadisë, e paditësit N.K. nga Prizreni, për 23 ditë pune nga 2 euro për ditë, nga data (22.11.2022 e deri më 30.12.2022) në shumë prej 46 euro **refuzohet si e pa bazuar.**
- IV. DETYROHET** e paditura që paditësit t’ia kompensoj shpenzimet e procedurës kontestimore në shumë prej **124 (njëqind e njëzetë e katër) euro**, në afat prej 7 ditësh nga pranimi i këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarimit të detyrueshëm

A r s y e t i m

Paditësi N.K. nga Prizreni, të cilën me autorizim e përfaqësojnë avokatët B.K. dhe F.G. nga Prizreni, pranë kësaj gjykate, me dt.27.10.2023, ka parashtruar padi, kundër të paditurës, – Masht me objekt të padisë kompensimi i shujtave ditore, vlera e kontestit 418.00 euro.

I autorizuari i paditësit, në padi ka theksuar se paditësi, N.K. punon pranë Qendrës Burimore “Nënë Tereza” në Prizren, – Masht në Prishtinë. Paditësi gjatë vitit 2022, ka qenë në marrëdhënie pune dhe ka punuar si në vijim ka 209 ditë pune. Duke u bazuar në të drejtat e punës, konkretisht nga Ligji i Punës si dhe Kontrata Sektoriale e Arsimit në Kosovë, paditësja ka bërë përpjekje për realizimin e të drejtave të tyre lidhur me pagesat e shujtave të vitit 2022, por përpjekja e tyre ka rezultuar pa sukses. Gjykatës i ka propozuar, që e njëjta të merr aktgjykim dhe padinë e kërkesëpadinë e paditësit Naim Kryeziu, nga Prizreni, ta aprovojë në tërësi si të bazuar. Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar.

E paditura, përmes Avokaturës Shtetërore në përgjigjen në padi e ka kontestuar padinë dhe kërkesëpadinë e paditëses, lidhur me kompensimin nga marrëdhënia e punës. Ka theksuar se kompensimi i kërkuar në emër të shujtave nuk është paraparë me Ligjin e Punës. Si dhe kërkesëpadia e paditësit është parashkruar siç është përcaktuar me nenin 87 të LP-së .

Gjykata pas shqyrtimit të padisë, provave që gjenden në shkresat e lëndës, si dhe përgjigjes në padi të paraqitur nga ana e të paditurës, në kuptim të nenit 8 lidhur me nenin 398 të LPK-së, gjeti se kërkesëpadia e paditëses është pjesërisht e bazuar, andaj pa shqyrtim të çështjes, e aprovoi pjesërisht kërkesëpadinë si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Mes palëve nuk rezulton të jetë kontestues fakti se paditësi është në marrëdhënie pune tek e paditura, përkatësisht edukator në konvikt, pranë Qendrës Burimore “Nënë Tereza” në Prizren.

Gjykata përmes vërtetimit me nr. të referencës 84/2023, të dt.30.03.2023, të lëshuara nga ana e drejtorit të Q.B.M.K “Nënë Tereza” në Prizren, vërtetoi faktin se paditësi N.K. gjatë vitit 2022, ka punuar 209 ditë pune . Ndërsa nëpërmjet njoftimit nga Drejtori i shkollës Qendra Burimore për Mësim dhe Këshillim “Nënë Terezë” gjykata ka vërtetuar faktin se nga data 22.11.2022 deri më datë 30.12.2022 kanë qenë 23 ditë pune.

Vërtetimin e lartcekura, Gjykata e pranoi si provë materiale vendimtare, në kuptim të nenit 329 par.1, të LPK-së, në të cilin paragraf përcaktohet se “*Shkresa të cilën e ka hartuar në formën e caktuar organi shtetëror brenda kufijve të kompetencës së vet, si dhe shkresa të cilën në formë të tillë e ka hartuar ndërmarrja apo organizata tjetër në ushtrimin e autorizimeve publike që i janë besuar me ligj (dokumenti publik), provon saktësinë e asaj që konfirmohet apo caktohet në të*”. Andaj pasi këto vërtetim janë lëshuar nga vet e paditura brenda fushëveprimit të saj, ashtu që vërtetimeve të Q.B.M.K “Nënë Tereza” në Prizren, gjykata i’a fali besimin e plotë, si provë me të cilën vërtetohet fakti lidhur me ditët e punës gjatë vitit 2022 respektivisht nga data 01.01.2022 deri më datë 21.11.2022 , konkretisht paditësi N.K. ka punuar 186 ditë pune pasi që Kolektive të Arsimit në Kosovë, me nr.01/B, nr. prot. 105, e dt.22.01.2021 ka qenë në fuqi deri më datë 21.11.2022 duke u bazuar në pikën III të mendimin juridik të Gjykatës Supreme, numër 214/2023 datë 05.10.2023 ku parashihet që Kontrata Kolektive e Arsimit në Kosovë e lidhur më datë 22.01.2021 aplikohet në periudhë 22.01.2021 e deri më datë 21.11.2022.

Bazuar në faktet e çështjes, Gjykata gjen se në rastin në fjalë zbatohen dispozitat e Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë, me nr.01/B, nr. prot. 105, e dt.22.01.2021, të nënshkruar në mes të Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë dhe Sindikatës së Bashkuar të Arsimit, Shkencës dhe Kulturës, e cila ka hyrë në fuqi me datë 22.01.2021.

Sipas neni 35 par.7, të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë, me nr.01/B, nr. prot. 105, e dt.22.01.2021, *“Të punësuarve (anëtarë të SBAShK-ut), u sigurohet kompensim për ushqim gjatë punës, për ditët e pranisë në punë. Vlera e kompensimit të shpenzimeve të ushqimit në punë, për një ditë pune, është dy euro për të punësuarit të cilët kanë marrëdhënie pune primare në institucionet arsimore...”*.

Në rastin konkret gjykata gjeti se e paditura ka pasur për detyrim që paditëses si punëtore të arsimit t’ia paguaj kompensimin për shujtat ditore, konform detyrimeve që rrjedhin nga Kontrata Kolektive, e në kuptim të Nenit 55 par.1 dhe 2 të Ligjit të Punës. Rrjedhimisht lidhur me kompensimin e shujtave ditore të paditësit N.K. ka 186 ditë pune, të cilës i takon shuma prej 372.00 euro, Gjykata vendosi si në pikën II të dispozitivit të këtij aktgjykimi, duke u bazuar në nenin 35 par.7, të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë, me nr.01/B, nr. prot. 105, e dt.22.01.2021, pasi që për paditësen kërkesa për kompensimin e shujtave ditore është bërë e arritshme.

Gjykata me rastin e vendosjes, jashtë seancës gjyqësore, për pjesën aprovuese si në dispozitivin nën I dhe II, të këtij aktgjykimi është bazuar në dispozitën e nenit 398 të LPK-së, e cila dispozitë përcakton: *“Kur gjykata, pasi t’i arrijë përgjigja në padi, konstaton se ndërmjet palëve nuk është kontestuese gjendja faktike, dhe se nuk ekzistojnë pengesa të tjera për dhënien e vendimit meritor, atëherë ajo, pa caktuar fare seancë gjyqësore, mund ta jep aktgjykimin me të cilën e pranon si të themeltë kërkesëpadinë”* dhe atë pa caktuar seancë gjyqësore, pasi që vlerësoi se në rastin konkret, kërkesëpadia e paditësit për këtë pjesë është qartazi e themeltë pasi që bazohet në kontratën kolektive me nr.01/B, nr. prot. 105, e dt.22.01.2021, neni 35.7 ndërsa shuma e kompensimit vërtetohet nga provat që gjenden në shkresat e lëndës.

Ndërsa sa i përket pjesës refuzuese, jashtë seancës, gjykata vendosi si në dispozitivin nën III, të këtij aktgjykimi dhe atë në kuptim të nenit 399 paragrafi 1 të LPK-së *“Kur gjykata, pasi t’i arrijë përgjigja në padi, konstaton se nga faktet e treguara në padi nuk del themelësia e kërkesëpadisë, atëherë ajo do të jep vendimin meritor me të cilin refuzohet si e pathemeltë kërkesëpadia”*.

Gjykata, në kuptim të nenit 8 lidhur me nenin 399 të LPK-së, vendosi si në pikën III të dispozitivit të këtij aktgjykimi, pas vlerësimit të të gjitha provave të paraqitura ku ka konstatuar ditët e pranimit në punë për periudhën 22.11.2022 deri më datë 30.12.2022 për paditësin N.K. kanë qenë 23 ditë pune, e për të cilën periudhë kohore Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë, me nr.01/B, nr. prot. 105, e dt.22.01.2021 nuk ka qenë në fuqi pasi që MASHT ka shkëputur KKAK-së si dhe në bazë të mendimi juridik mendimin juridik të Gjykatës Supreme, numër 214/2023 datë 05.10.2023, mbi këtë bazë gjykata e gjeti e të pa bazuar kërkesëpadinë e paditëses për periudhën (22.11.2022 deri më datë 30.12.2022) në shumë 46 euro.

Gjykata vendosi sikurse në dispozitiv të këtij aktgjykimi duke aprovuar shumën përkatëse dhe duke llogaritur kamatën ligjore si në dispozitiv, bazuar në nenin 382 par. 1 dhe 2

të LMD-së, duke e llogaritur të njëjtën nga dita e parashtrimit të padisë në këtë gjykatë (27.10.2023), bazuar në Mendimin Juridik për Kamatën të Gjykatës Supreme të Kosovës nr. 265/2020 të datës 02.12.2020, pasi që në rastin konkret pala e paditura është vonuar në përmbushjen e obligimit ndaj palës paditëse.

Sa i përket kundërshtimeve të paditurës me përgjigj në padi, Gjykata vlerëson se të njëjtat nuk janë të bazuara mbi dispozitat ligjore dhe nuk mbështeten në ndonjë bazë faktike apo juridike, ndërsa çështja e mënyrës së pagesës, respektivisht mundësisë së pagesës nga ana e të paditurës nuk është rrethanë e natyrës juridike. Rrjedhimisht, gjykata erdhi në përfundim se faktet nuk ishin kontestuese dhe nuk ekzistojnë pengesa për dhënien e vendimit meritor. Ndërsa lidhur me pretendimet e të paditurës lidhur me parashkrimin e kërkesë së paditëses. Gjykata konstaton se kërkesa e paditëses nuk është parashkruar pasi që kërkesa e paditëses ka të bëjë me kërkesa që rrjedhin nga marrëdhënia e punës për vitin 2022 ndërsa padia është paraqitur në vitin 2023 pra brenda afatit 3 vjeçar siç parashihet me nenin 87 të LP-së

Vendimin që pala e paditur ti bartë shpenzimet e procedurës, gjykata e ka mbështetur në dispozitat e nenit 449, 452 dhe 463 të LPK-së, sipas Tarifës së Odës së Avokatëve, lartësia e shpenzimeve i referohet përpilimit të padisë në shumën prej 104 euro dhe taksës gjyqësore në shumën prej 20 euro, përkatësisht shumën e përgjithshme prej 124.00 euro.

Duke u bazuar në të dhënat e lartcekura, gjykata ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi në pajtim me dispozitat e nenit 398 dhe 399 të LPK-së.

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN
Departamenti i Përgjithshëm
C.nr.3392/2023, datë 12.03.2024

Gjyqtari

Taulant Rexhëbeqaj

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi pala e pa kënaqur ka të drejtë ankese në afatin prej 7 ditëve, pas pranimit të tij, Gjykatës së Apelit të Kosovës në Prishtinë, përmes kësaj gjykate. Ankesa duhet të paraqitet në kopje të mjaftueshme për palët dhe gjykatën.